

**Ne perputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723/2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ky dokument perben:**

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI

I

“EnMaX” Sh.P.K.

TIRANE / SHQIPERI

15.02.2024

## **Neni 1: Data e Themelimit dhe Emri**

- 1.1. Sot me date 15.02.2024, themelohet nga ortaket e saj, sipas legjislacionit shqiptar, shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "EnMaX" Shpk (ne vijim "Shoqeria"), e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk".
- 1.2. Ortaku i Shoqerise ("Ortaku") gezon pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar nga kuota/at.

## **Neni 2. Forma Ligjiore**

- 2.1. Shoqeria eshte nje person juridik shqiptar, dhe ka formen ligjiore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne pajtim me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 'Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare' ("Ligji i shoqerive tregtare").

## **Neni 3. Selia**

- 3.1. Ne momentin e nenshkrimit te ketij akti, selia qendrore e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga Asim Vokshi, Nd 16, H2, Njesia Bashkiake nr 9, 1016, Tirane. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise dhe kjo nuk do te konsiderohet si ndryshim i Statutit. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

## **Neni 4. Kohezgjatja**

- 4.1. Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje kohe te pacaktuar.

## **Neni 5. Objekti i Shoqerise**

Shërbime të menaxhimit të shoqërive tregtare. Pjesëmarrje në shoqëri të tjera, si dhe në organet e tyre drejtuese. Zhvillim ose ndermjetesim i veprimtarive të investimit, blerjes, shitjes, qeradhënies, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Implemetim dhe auditim i sistemeve të menaxhimit dhe të cilesise.

Konsulencë në optimizimin dhe menaxhimin e sistemeve ekonomike dhe financiare, të kontabilitetit dhe të menaxhimit të ndërmarrjeve. Konsulenca ekonomike, financiare dhe fiskale. Përgatitjen e planeve të biznesit dhe të investimit, zhvillimin dhe implementim projektsh, keshillime strategjike të biznesit dhe investimeve. Ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit të rekrutimit për punësi dhe menaxhimit të burimeve njerëzore. Implementimi i software në të gjitha platformat duke përfshirë proceset e analizës së biznesit, ridizenjimin e proceseve të punës, përfshirë zhvillimin, implementimin, hostimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Zhvillim ose ndërmjetësim i trajnimeve dhe kurseve profesionale në fushën e zhvillimit të Software, Teknologjisë së Informacionit, fushën e menaxhimit dhe kontabilitetit.

#### **Neni 6. Kapitali Themeltar**

Kapitali i Shoqërisë është në total 100.000 Leke (një qind mijë) i ndarë në 1 kuotë.

#### **Neni 7. Ortaket dhe Kuotat**

Në datën e themelimit Shoqëria ka ortaket vijues që zoterojnë Kuotat përkatëse të Shoqërisë, si mëposhtë:

- Endri Hasa i datelindjes 16.02.1981 me ID I10216002T zoteron 1 Kuotë me vlerë 100.000 Leke

#### **Neni 8. Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit**

Kapitali mund të zmadhohet ose zvogelohet me vendim të Ortakëve në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit për Shoqëritë.

#### **Neni 9. Te drejtat dhe detyrimet e Ortakëve**

10.1. Ortaket janë vetëm ata të cilët zoterojnë kuota në Shoqëri.

10.2. Çdo Ortak do të ketë të dehta votë në përpjestim me përqindjen e kontributit të zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë dhe që përfaqësohet nga Kuota e tij ose pjesë e Kuotes së tij. Çdo Ortak ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, sikundër të drejtat e parashikuara nga ky Statut, dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Shoqëritë.

- 10.3. Ortakut do t'i jepen, pas kërkeses me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojnë dokumentat dhe raportet e Shoqërisë.
- 10.4. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotes/tave, transferohen tek çdo zotëruar i ri për këtë Kuota.
- 10.5. Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaku mban përgjegjësi brenda limitit të vlerës së Kuotes që zotëron. Ortaku nuk mban përgjegjësi mbi vlerën e investimit të tij në kapitalin e Shoqërisë (përveç garancive dhe huave që ata leshojnë).
- 10.6. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortakëve të saj.

#### **Neni 10. Administratoreve dhe kompetencat**

- 11.1. Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë Administrator/re, sipas vendimit të Ortakëve.
- 11.2. Në momentin dhe për qëllimin e miratimit të këtij statuti Administrator i Shoqërisë është: Endri Hasa me ID I10216002T i cila emërohet për një periudhë prej 5 (pese) vjet, nga data e themelimit të Shoqërisë, të përcaktuar në këtë dokument.

#### **Neni 11. Të tjera**

- 12.1. Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë.

ORTAKET

Endri Hasa